



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2142/8 Prot.

Tiranë më 14.11.2024

VENDIM

Nr. 28, datë 14.11.2024

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Qendra e Shërbimeve Arsimore” (në vijim, “Kontrolluesi ose QSHA”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 166, datë 01.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit Nr. 33, datë 27.06.2023 të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale për Kontrolluesin “Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. “QSHA” është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit, krijimin e bazës shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit, administrimin e bazës së të dhënave për arsimin parauniversitar.

2. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 1 dhe 3 të dispozitivit të Rekomandimit nr. 33, datë 27.06.2023 të Komisionerit (në vijim, “Rekomandimi”), për marrjen e masave për procesin e “login/identifikimit” të punonjësve administrativ në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (në vijim, “SMIP”) nëpërmjet llogarisë personale të krijuar në “Modulin Qytetar” në portalin “e-Albania”.

Punëmarrësit, mund të log-ohen në sistemin SMIP në dy mënyra, nëpërmjet llogarisë si qytetar në “e-Albania”, si dhe si punonjës administrativ i institucionit.

Nga verifikimi në vend rezulton se, të dhënat që lejojnë punonjësit administrativ të aksesojnë sistemin SMIP janë: “NID” dhe “fjalëkalimi” i llogarisë personale në portalin “e-Albania”, të krijuara në “Modulin Qytetar”. Përdoruesit administrativ të sistemit mund të logohen sipas modelit “Single SignOn” (SSO), nëpërmjet llogarisë personale në portalin “e-Albania”, në kundërshtim me kërkesat dhe parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji, QSHA, në cilësinë e Kontrolluesit të të dhënave personale, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për t’u mundësuar aksesin punonjësve administrativ të sistemit SMIP, pa qenë nevoja e përdorimit të të dhënave të llogarisë personale në portalin “e-Albania”, të cilat mbliidhen dhe përpunohen për një tjetër qëllim.

Gjithashtu, Kontrolluesi, duhet të marrë masa për rregullimin e këtij procesi, në mënyrë që të jetë në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, konkretisht duke ofruar një mekanizëm për identifikimin e punonjësve administrativë, në sistemin SMIP, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

3. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 4 të dispozitivit të Rekomandimit, për publikimin e “Politikave të Privatësisë” në faqen zyrtare www.smip.al dhe në aplikacionet mobile SMIP në platformat “Play Store” dhe “App Store”.

Konstatohet se, subjektet e të dhënave nuk informohen në lidhje me mënyrën e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi, në kundërshtim kjo me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo Kontrollues që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, me qëllim informimin paraprak të subjekteve të të dhënave, përpara se ky përpunim të fillojë.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e

këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 5 të dispozitivit të Rekomandimit, për hartimin e një akti/marrëveshje për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit SMIP, me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në vijim, “AKSHI) apo me Operatorin Ekonomik (OE).

Konstatohet se, QSHA nuk ka hartuar një marrëveshje/kontratë për përcaktimin e detyrimeve midis palëve mbi përpunimin e të dhënave personale në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

5. Lidhur me pikën 6 të dispozitivit të Rekomandimit, rezulton se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin e Formularit të “Njoftimit”.

Megjithatë, pas vënies në dijeni të Urdhrit të hetimit administrativ nr. 166, datë 01.10.2024 të Komisionerit, Kontrolluesi nëpërmjet email-it ka depozituar Formularin e “Njoftimit” të përditësuar.

Nga verifikimi i Formularit të “Njoftimit”, si dhe regjistrin elektronik të kontrolluesve të Zyrës së Komisionerit rezulton se, “Deklarata e Ndryshimit” e depozituar datë 17.10.2024, është trajtuar nga Kontrolluesi si *Deklaratë e parë* dhe nuk ka reflektuar ndryshimet sipas rekomandimeve të Komisionerit.

Në përmbajtje të “Deklaratës së Ndryshimit” të datës 17.10.2024, është konstatuar se ka mangësi, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si por pa u kufizuar: *vizitorë, etj.*”;
- ii. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*Të dhënat sensitive që përpunohen*”;

- iii. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përpunimit*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Marrësit e të dhënave personale*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*AKSHI, Banka, etj.*”.
- v. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Qëllimi i përhapjes*”, të tilla si por pa u kufizuar: “*Detyrim ligjor, etj.*”

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i përditësimit për ndryshimin e gjendjes së “*Njoftimit*” të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

6. Lidhur me pikën 7 të dispozitivit të Rekomandimit, Kontrolluesi vendosi në dispozicion Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore*”, e cila është miratuar me Urdhër nr. 84, datë 22.09.2020 “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore*”.

Ky dokument rezulton të jetë i njëjtë, me Rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore*”, e cila është administruar gjatë hetimit të vitit 2023.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konstaton se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për plotësimin e detyrimeve të Rekomandimit. Rregullorja nuk parashikon qartësisht proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

7. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 8 të dispozitivit të Rekomandimit, për demonstrimin e kontrollit të plotë për të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë*”

së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Në bazë të pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, “*Kontrollues*”, është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, si dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

QSHA ka detyrimin të demonstrojë kontrollin e plotë mbi të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, QSHA nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore datë 05.11.2024, dhe kanë depozituar pretendimet me shkrim si dhe dokumentacion plotësues mbi konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ. Kontrolluesi parashtroi argumentet e përmbledhura, si më poshtë:

- Lidhur me konstatimin për identifikimin e punonjësve administrativ në sistemin SMIP, QSHA argumenton se, në datë 05.11.2024 (mbas marrjes në dijeni të Procesverbalit të konstatimeve) ka dërguar kërkesë me email drejtuar operatorit ekonomik i cili kryen mirëmbajtjen e SMIP dhe ka vendosur në dijeni (cc) përfaqësues të AKSHI-it, që procesi i log-in/identifikimi të kryhet drejtpërdrejtë pa përdorur llogarinë personale të punonjësve të krijuar në modulin qytetar në portalin e-Albania.
- Lidhur me konstatimin që, kontrolluesi nuk ka publikuar politikat e privatësisë në faqen e internetit dhe në aplikacionet mobile, QSHA argumenton se, në datë 22.10.2024 (mbas fillimit të hetimit administrativ) ka kërkuar suportin e AKSHI për të vendosur Politikat e Privatësisë në faqen zyrtare si dhe në aplikacion pasi stafi IT është i atashuar nga AKSHI.

- Lidhur me konstatimin që, Kontrolluesi nuk ka marrë masa për hartimin e një Marrëveshje Shërbimi/Kontratë për ofrimin e mirëmbajtjes dhe hostimit të SMIP, argumenton se “...QSHA ka deklaruar që pronari shtet i sistemeve të QSHA është vetë AKSHI dhe rrjedhimisht dhe i të dhënave të SMIP. Gjithashtu na lejoni t’ju bëjmë me dije se për shkak të politikave të sigurisë së AKSHI-t, QSHA e ka të pamundur të shkarkojë të dhëna në mënyrë që t’i delegojë ato në palë të treta”.

Referuar pretendimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit vlerëson se, sipas pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, QSHA, gëzon cilësinë e kontrolluesit, sa i përket përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit SMIP, për rrjedhojë duhet të marrë masa për hartimin e një akti/marrëveshje për ofrimin e mirëmbajtjes së sistemit SMIP.

- Lidhur me konstatimin se, Kontrolluesi nuk ka përditësuar “Formularin e Njoftimit”, QSHA ka dorëzuar Formularin “Deklaratë Ndryshimi” të përditësuar pas zhvillimit të seancës dëgjimore.
- Lidhur me konstatimin se, Kontrolluesi disponon Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore”, por konstatohet se kjo Rregullore nuk parashikon qartësisht proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, QSHA argumenton se “...pas Rekomandimit ka hartuar Rregulloren e re të cilat janë cilësuar edhe si prova në procesverbal”.

Kontrolluesi ka depozituar si provë materiale në dosjen e hetimit, dokumentet si më poshtë:

- 1- Urdhër nr. 589, datë 16.10.2023 “Për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar” dhe Rregullorja bashkëlidhur;
- 2- Rregullore për sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar;
- 3- Urdhër nr. 84, datë 22.09.2020 “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe bazës së të dhënave shtetërore” dhe Rregullorja bashkëlidhur;
- 4- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, nr. 730/1 prot., datë 28.01.2020.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të mësipërm rezulton se asnjë prej tyre nuk ka të parashikuara rregulla specifike mbi proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative për çdo kategori të dhënash që përpunohen, bazuar në veprimtarinë e Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin,

nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

- Lidhur me pikën 7 të konstatimeve, QSHA deklaroi se “...Sipas Urdhrit të MAS nr. 589, datë 06.10.2023 “Për miratimin e rregullores për përdorimin e SMIP”, shprehen qartësisht detyrat e QSHA si përdorues në këtë sistem. QSHA në rolin e administratorit e ka të pamundur modifikimin apo shkarkimin e të dhënave nga SMIP. Gjithashtu, për çdo problematikë teknike, QSHA komunikon me AKSHI dhe OE që kryen mirëmbajtjen e sistemit pasi nuk ka akses të kryejë asnjë ndryshim. Masat teknike dhe organizative që ka marrë QSHA, reflektohen tek politikat e privatësisë dhe sigurisë të cilat gjenden të publikuara në faqen zyrtare të QSHA”.

Referuar pikës 5, të nenit 3 të Ligjit, QSHA, gëzon cilësinë e kontrolluesit, sa i përket përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit SMIP. Rrjedhimisht, QSHA ka detyrimin të demonstrojë kontrollin e plotë mbi të dhënat personale që përpunohen nëpërmjet SMIP, si dhe të përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji.

Politikat e privatësisë të publikuara në faqen zyrtare të QSHA, kanë të bëjnë me informimin e subjekteve të të dhënave dhe jo me masat teknike-organizative lidhur me përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit SMIP.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, QSHA, në cilësinë e Kontrolluesit, ka detyrimin të garantojë dhe të marrë masa mbi sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në zbatim të parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a” “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit që nuk përmbushin detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mos përmbushjes të detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit, ka vlerësuar mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, si dhe shkallën e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 39 (pika 1, gërmat “a”, “b”, “ç” dhe “dh”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqindë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqindë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
4. Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lek, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa lidhur me identifikimin e punonjësve administrativ në sistemin SMIP, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave në faqen zyrtare www.smip.al dhe aplikacionet e regjistruara në “Play Store” dhe “App Store”;
7. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, për hartimin e një akti/marrëveshje për ofrimin e mirëmbajtjes së sistemit SMIP;
8. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
9. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete

teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;

10. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të marrë zbatoj detyrimet e përcaktuara në nenin 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit;
11. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 8 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 5, 6 dhe 7 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 9 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 10 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

12. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
13. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
14. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 14.11.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi